



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosova  
**Komuna e Novobërdës**  
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

---

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

---

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa  
Z/znj \_\_\_\_\_

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

**F T O J**

Mbledhjen e dhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më **22.10.2019** ( e martë) duke filluar ne ora **10:00**.

**R e n d i i d i t ë s**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Shqyrtimi i Raportit Financiar për tremujorin e tretë (Korrik - Shtator) për vitin 2019;
3. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:16.10.2019  
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit  
Nebojsa Arsic



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosova  
**Komuna e Novobërdës**  
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e nëntë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 17.09.2019, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesusi i Kuvendit Nebojsa Arsic, Anëtarët e KPF-së: Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Selatin Nuhiu, Drejtori i Financave Sercan Todorovic dhe perfaqësuesi i OSBE-së.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

**R e n d d i t e**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Shqyrtimi i propozim buxhetit për vitin 2020-2022;
3. Të ndryshme.

Kryesusi tha: a keni ndonjë propozim apo pajtoheni me këtë rend dite?  
Pasi nuk pati propozime aprovohet njëzëri rendi i ditës.

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;

Kryesusi tha: në gjuhen serbe nuk është derguar procesverbali për arsye se perkthyesi është në pushim mjeksordhe ne mbledhjen e ardhshme do ta keni të dy procesverbalet.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: unë e kam marr materialin në gjuhen shqipe mirëpo po më duket shumë e padrejt pasi që shumë shpesh po ndodh që po mungon materiali në gjuhen serbe dhe ne fund të dalim me një kerkes që të jet secili i pergjegjshëm për punën e vet pasi që kështu nuk punohet, kush e ka pergjegjësini që të perkthej le ta perkthej, pushim ka të drejt që të merr por të pakten ta perfundoj dikush tjetër që e zavendeson, mua personalisht nuk po më vjen mirë.

Pasi nuk pati diskutime procesverbali aprovohet me 4 vota për dhe 1 apstenim nga antarët e KPF-së.

**Pika e dytë:** Shqyrtimi i propozim buxhetit për vitin 2020-2022;

Kryesuesi tha: siç e dini në fund të shtatorit është afati i fundit për aprovimin e buxhetit, ne e kemi marr materialin sa i perket buxhetit dhe ja dha fjalen Drejtorit të Financave që të na prezantoj.  
Sercan Todorovic pasi pershendeti të pranishmit tha: materialin për propozim buxhetin e kemi derguar, në bazë të qarkores që e ka derguar Ministra dhe në bazë të debateve që i kemi organizaur ne kemi pregaditur propozim buxhetin. Buxheti në total për vitin e ardhshëm është 3,075,633€, shpenzime kapitale janë 347,721€, subvencione janë 40,000€, shpenzime Komunale janë 70,000€ dhe tjerat janë për paga dhe meditje I keni për secilen drejtori veç e veç, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.  
Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: i kanë organizuar drejtorja e financave degjimet publike, unë kam marr pjesë por shumë pak ka pasur qytetar në fshatin Llabjan ndërsa në Pasjak asnjë qytetar nuk ka marr pjesë ku ka qenë problemi unë nuk e di. Sa I perket organizimit prej Kuvendit për degjim publik ka qenë jashtzakonisht mirë pasi që ka pas shumë perfaqësues të fshatrave të gjithë kan propozuar për fshatrat e tyre dhe unë I kam shenuar të gjitha dhe unë ju dorzoj kopje fizik dhe ne si Kuvend do ti perkrahmi, e di se me at shumë që e kemi është e pamundur me u perkrah të gjitha por në secilin vend ti marmi prioritetet, më vjen keq që atë dit nuk ka pasur asnjë kerkes nga komuniteti serb prej qytetarëve, vetem Drejtori nga ezgjektivi që ka paraqit kerkesat, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: në I kemi pasur katër degjime publike unë ftesat për degjim public ju kam derguar të gjithë antarëve të Kuvendit, në fshatin Llabjan ka pasur qytetar në degjim public edhe ne fshatrat serbe ka pasur qytetar dhe ka pasur kerkesa në degjime publike që I kemi organizuar ne dhe I kemi shkruar kerkesat e tyreandaj nuk ka pasur kerkesa në debatin e fundit.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: ne po e shohim se për investime kapitale në këtë vit është një buxhet më I vogel se vitin e kaluar, kjo shumë është shumë e vogel për tu realizuar kerkesat e qytetarëve sikur të kishim edhe miliona euro nuk do ti mbulonim të gjitha kerkesat e qytetarëve por mendoj se në duhet të kordinohemi aty ku janë kerkesat më urgjente dhe ato që janë më prioritare. Sa I perket buxhetit për investime kapitale I cili ka ndodhur në vitin e kaluar, për herë të parë në si kshilltar komunal dhe qytetarët e kanë ditë se cilat projekte do të realizohen në këtë vit, disa projekte knaë filluar disa janë në procedur e siper. Por disa qytetar po e keqperdorin po mundohen me anashkalu punën tonë si antarë të Kuvendit që e kemi bërë deri tani e kemi rastin për kanalizimin në fshatin Tullarë në këtë projekt e kemi propozuar në vitin e kaluar ndërsa është propozuar perseri në debat public. Besoj se dhe këtë vit do ta organizojm si vitin e kaluar dhe do tju dhëjmë prioritet aty ku ka nevoj më shumë, ju faleminderit.

Milica Jovanovic pasi pershendeti të pranishmit tha: kam degjuar se dikush nga fshati Pasjak se ka thënë që duhet të investohet më shumë posht se në kodra, ndërsa unë mendoj se duhet të investohet në mënyrë të barabart.

Xhejlane Behluli tha: kam marr pjesë në takim dhe shumë mirë e di se si e ka thënë, perfaqësuesi I fshatit Pasjak Naser Ibrahimimi nese e ke mbajt men e ka permend tatimin në pronë, pasi në Pajsak tatimi në pronë paguhet si me qenë në qender të Gjilanit e në atë pjesen posht perfshihet Pasjaki, Kufca dhe Stanishori janë zonë e parë dhe kur janë taksapaguesit më të mëdhenj duhet edhe investime të bëhen por jo duke ju lënë anash juve. Në fshatin Pasjak prej vitit 2013 nuk është investuar asgjë.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

**Pika e tretë:** Të ndryshme.

Kryesuesi e hap diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovanovic tha: pasi që nuk e kemi marr procesverbalin e mbledhjes së kaluar kerkoj gjithashtu edhe procesverbalet e muajit nentor dhe dhjetor të vitit 2018.

Mirjana Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket fshatit Koretisht është problemi i furnizimit me ujë pasi që 6 vite nuk punon pasi që është borgji i rrymes, është nënshkruar një marrëveshje me Hidromoraven e Gjilanit por pa u paguar ky borgj ata nuk po intervenojn dhe të gjithë e dim se është thatësi e madhe dhe njerëzit po kan probleme, nuk e di pse që 6 vite nuk është kryer kjo pages e rrymes si dhe pse ka kaluar në hidromorav pa u kryer pagesa?, a egziston ndonjë mundësi që të zgjidhet kjo?  
Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:35.

Procesëmbajtëse  
Valmire Mustafa



Kryesues i Kuvendit  
Nebojsa Arsic

